



JU MERITONI KUJDES SHËNDETËSOR TË PËRBALLUESHËM

"NY State of Health" ofron plane shëndetësore të përballueshme dhe mbështetje financiare për të ulur kostot tuaja. Merrni ndihmë të personalizuar falas nga asistentët për të krahasuar planet dhe për të zgjedhur mbulimin më të mirë për ju.

NË "NY STATE OF HEALTH", DO TË GJENI

- 1 Shumë plane shëndetësore ekonomike dhe cilësore
- 2 Plane me kujdes parandalues falas dhe me prime të ulëta
- 3 Ndihmë falas ballë për ballë për të zgjedhur planin tuaj
- 4 Ndihmë financiare për t'ju ndihmuar të paguani mbulimin tuaj
- 5 "Essential Plan" për individë me të ardhura më të ulëta

REGJISTRIMI ËSHTË I THJESHTË! MBANI GATI INFORMACIONET E MËPOSHTME PËR VETEN DHE ÇDO ANËTAR TË FAMILJES SUAJ

- ✓ Datëlindjet
- ✓ Numrat e sigurimeve shoqërore ose, për emigrantët e ligjshëm, numrat e dokumenteve, nëse janë të disponueshëm
- ✓ Të dhënat që kanë të bëjnë me punësimin dhe të ardhurat dhe të dhëna për sigurimet shëndetësore



KRAHASONI PLANET DHE REGJISTROHUNI SOT!

1-855-355-5777 ose
TTY: 1-800-662-1220

nystateofhealth.ny.gov
Ndihmë falas në person

THE ESSENTIAL PLAN

"Essential Plan" është i duhuri për shumë individë me të ardhura më të ulëta.

Për disa individë, ai kushton më pak se një dollar në ditë. Për të tjerë, nuk ka asnjë kosto.

DHE NUK KA TARIFA TË ZBRITSHME, prandaj plani e fillon menjëherë pagesën për kujdesin tuaj shëndetësor.

"ESSENTIAL PLAN" OFRON TË NJËJTAT PËRFITIME CILËSORE SIKURSE EDHE PLANET E TJERA SHËNDETËSORE



Vizita te mjekët, ku përfshihen vizitat te specialistët



Ekzaminime të këshilluara nga mjeku



Ilaçe që merren me recetë



Kujdes për pacientët e shtruar dhe të jashtëm në një spital

Sipas "Essential Plan", pjesa që paguani për çdo shërbim shëndetësor – bashkëpagesa juaj – është gjithashtu shumë e ulët, ndonjëherë edhe 0 \$.

Dhe shërbimet e parandalimit janë falas, duke përfshirë ekzaminimet dhe kontrollet rutinë te mjeku.



Abonohuni sot për "Essential Plan".

Regjistrimi është i hapur **GJATË GJITHË VITIT**.